



Matura Shtetërore: Kronikë i një eksodi të paralajmëruar!

RAPORT MONITORIMI

Maj-Korrik 2023

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al



AUTOR

GEVIO TABAKU

Arritjet dhe sfidat e Maturës Shtetërore 2023

Matura shtetërore e vitit 2023 u zhvillua në intervalin 1 deri më 19 qershor. Provimet e maturës përbëjnë një proces të rëndësishëm për maturantët në mënyrë që rezultatet e tyre në këto provime të përkthehen në pikë të cilat llogariten në aplikimin e tyre universitar.

Numri i maturantëve gjatë këtij viti ishte 27 180 në provimin e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë, 27 543 në provimin e Matematikës, 27 263 në provimin e Gjuhës së Huaj, si edhe 27 389 në provimin e lëndës me zgjedhje. Në krahasim me vitin e kaluar, numri i maturantëve është rreth 7% më pak.

Për të garantuar një proces të rregullt dhe për të parandaluar shkeljen e rregullores nga maturantët dhe administratorët, Ministria e Arsimit njoftoi marrjen e masave shtesë në zhvillimin e maturës shtetërore të këtij viti. Ministria e Arsimit, znj. Evis Kushi udhëzoi për vendosjen e maturantëve në salla të mëdha, të pajisura me kamera dhe rritje të kontrolleve.

Pavarësisht vendosjes së këtyre masave, procesi nuk shkoi pa probleme. Maturantët gjetën mënyrën për të marrë me vete telefonin e tyre celular në ambientet e zhvillimit të provimit, duke e përdorur atë si mjet për të kopjuar¹. Në një deklaratë për mediat, Ministria e Arsimit, znj. Evis Kushi, theksoi se paçka se publikimi i tezave në rrjete sociale përbën shkelje të rregullores, procesi nuk cënohet².

Ndryshe nga vitet e kaluara ku maturantët kanë kontestuar në masë hartimin e një ose më shumë provimeve duke i konsideruar ato jashtë programit orientues, këtë vit nuk pati reagime me anë të protestave.

Notat e provimeve të maturës: Krahasim ndër vite

Nota mesatare e maturantëve në secilin provim

Viti	Gjuhë shqipe dhe letërsi	Matematikë	Gjuhë e huaj	Me zgjedhje
2023	7,34	6,65	7,68	7,30
2022	7,46	6,88	7,72	7,52
2021	7,00	6,40	7,38	7,54

Numri total i maturantëve mbetës përgjatë tri viteve të fundit

Viti	Maturantë në total	Mbetës, notë 4.00 (total)	Të shkëlqyer, notë 10.00 (total)
2023	27 543	3782 (3,4%)	790 (0,7%)
2022	29 829	4117 (3,4%)	977 (0,8%)
2021	32 805	9014 (6,8%)	237 (0,1%)

¹ <https://shqiptarja.com/lajm/sot-provimi-i-trete-i-matures-shteterore-30-mije-maturante-testohen-ne-lenden-e-matemaikes>

² <https://gazetasi.al/publikimi-i-tezes-se-provimit-te-matures-ministrja-kushi-detaj-qe-nuk-cenon-procesin/>

Tab 1. Llogaritur si numri total i maturantëve mbetës dhe të shkëlqyer në të katërta provimet e maturës. Numri total i maturantëve është llogaritur duke marrë numrin më të lartë të maturantëve pjesëmarrës në një provim.

Gjatë analizës së notave të provimeve të maturës ndër vite, vihet re numri në renie me gati **2 600** maturantë në vit. Sipas këtij projeksioni, matura e vitit 2024 do të këtë rreth 24 900 maturantë, çka shpreh situatën në të cilën ndodhet vendi ne lidhje me ikjen masive të të rinjve. Referuar të dhënave të QSHA³, rreth 39.4% e maturantëve të këtij viti kanë shprehur dëshirën për të studiuar jashtë vendit gjatë plotësimit të formularit A1⁴.

Në vitin 2021, 6,8% e maturantëve kanë rezultuar mbetës në provimet e maturës, me shumicën e tyre që ka mbetur në provimin e matematikës (3018 maturantë). Po ashtu, vetëm 237 maturantë kanë arritur të marrin notën 10.00. Numri i mbetësve në të katër provimet e maturës për vitin 2022 dhe 2023 është i njëjtë, respektivisht 3,4% në 2022 dhe 3,4% në 2023. Numri i maturantëve të shkëlqyer për maturën e vitit 2022 është 0,8%, ndërsa për vitin 2023 është 0,7%, me një diferencë prej 0.1%, në krahasim me vetëm 0.1% të maturantëve të shkëlqyer në total në vitin 2021.

Maturantët mbetës dhe të shkëlqyer sipas provimeve, ndër vite

2023

Provimi	Mbetës, notë 4.00	Të shkëlqyer, notë 10.00
Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	444	15
Matematikë	1549	238
Gjuhë e huaj	1043	384
Me zgjedhje	746	153

2022

Provimi	Mbetës, notë 4.00	Të shkëlqyer, notë 10.00
Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	383	4
Matematikë	1729	234
Gjuhë e huaj	611	611
Me zgjedhje	1144	128

³

http://qsha.gov.al/infos/program_transparenca/regjistriri%20i%20kerkesave%20dhe%20pergjigjeve%202023,%20tre%20mujori%20i%20dyte.xlsx

⁴ Formular i cili shërben për regjistrimin e maturantëve në procesin e maturës shtetërore.

2021

Provimi	Mbetës, notë 4.00	Të shkëlqyer, notë 10.00
Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	1911	2
Matematikë	3018	4
Gjuhë e huaj	2199	36
Me zgjedhje	1886	231

Sipas analizës së kryer, matematika është provimi më i vështirë për maturantët. Gjatë tre viteve të fundit, në këtë provim kanë mbetur 6296 maturantë. Pas matematikës, vjen provimi i gjuhës së huaj, me 3853 maturantë. Në vend të tretë është provimi me zgjedhje, që ka 3776 maturantë mbetës. Në fund, provimi i gjuhës shqipe dhe letërsisë me 2738 maturantë i cili është provimi me kalueshmërinë më të lartë.

Provimi më i vështirë për të fituar notën 10.00 është provimi i gjuhës shqipe dhe letërsisë, pasi vetëm 21 maturantë kanë arritur këtë rezultat në tre vitet e fundit. Në vend të dytë është provimi i matematikës me 476 maturantë. Pas tij vjen provimi me zgjedhje, ku janë 512 maturantë dhe në fund, provimi i gjuhës së huaj me 1031 maturantë të cilët kanë arritur rezultatin maksimal, notën 10.00.

Notat e provimeve të maturës kundrejt mesatares vjetore të nxënësve

Fiktiviteti i notave është një problem kryesor në sistemin arsimor parauniversitar në Shqipëri. Kjo nënkupton se notat që nxënësit marrin gjatë vitit shkollor nuk korrespondojnë me notat e tyre në provimet e maturës shtetërore. Ka ndryshime të ndjeshme midis notës mesatare vjetore dhe notave që nxënësit marrin në provimet e maturës.

Raporti publik për arritjet e nxënësve të maturës shtetërore për vitin shkollor 2020-2021 tregon se numri total i nxënësve me notë mesatare 10 në të gjitha vitet e shkollës së mesme ishte 1249. Megjithatë, asnjë prej këtyre nxënësve nuk arriti të marrë notën 10.00 në të gjitha provimet e maturës. Në fakt, vetëm 8% prej tyre arritën të marrin notën 10 në një provim, ndërsa vetëm 0.3% arritën të marrin notën 10 në dy provime.

Raporti publik për Maturën Shtetërore për vitin shkollor 2021-2022 tregon se ka një pjesë nxënësish që kanë një ndryshim të theksuar në notën mesatare vjetore kur krahasohet me notën e tyre në provimet e maturës. Për shembull, 5.6% e nxënësve kanë përmirësim me 3-5 nota në provimin e matematikës, ndërsa rreth 2.5% kanë një zvogëlim të notës. Një situatë e ngjashme shihet

edhe në provimin e gjuhës shqipe dhe letërsisë, ku rreth 3.1% e nxënësve kanë një zvogëlim me 3-5 nota.

Analiza e kryer në provimin e matematikës tregon se qarku me ndryshimin më të theksuar të notave është Kukësi, ku 8.8% e maturantëve kanë një diferencë prej ± 4 nota. Kjo tregon se në këtë qark procesi i provimeve të maturës shtetërore nuk administrohet në mënyrën e përcaktuar në rregullore.

Të dhënat e mesatareve për çdo qark të maturës së vitit 2022 vërtetojnë këto zbulime, ku qarku Kukës kryeson listën me një mesatare prej 8.43. Kjo mesatare është 1.46 njesi-notë më e lartë se mesatarja e qarqeve të tjera duke treguar një ndryshim të dukshëm midis arritjeve të nxënësve në provimet e maturës shtetërore në krahasim me notën mesatare vjetore të tyre.

Provimi	Qarku	Mesatarja
Matematikë	Kukës	8,43
	Durrës	7,45
	Lezhë	7,42
	Tiranë	7,17
	Shkodër	7,09
	Dibër	7,03
	Gjirokastër	6,97
	Elbasan	6,96
	Fier	6,93
	Korçë	6,88
	Vlorë	6,73
	Berat	6,08

Të dhënat janë marrë nga PortaliStudentor.al.

Moskorrespondenca midis arritjeve reale të nxënësve dhe notave që ata marrin gjatë vitit shkollor krijon hapësira për humbjen e saktësisë dhe besueshmërisë së notave si tregues të arritjeve akademike të tyre. Kjo situatë minon meritokracinë, veçanërisht në momentin kur këta nxënës aplikojnë për të filluar studimet e larta.

Detyrimi për punësimin e mjekëve të rinj pas diplomimit

Më datë 17 qershor 2023, Ministria e Arsimit, Znj. Evis Kushi, së bashku me Ministren e Shëndetësisë, Znj. Ogerta Manastirliu, si dhe me Rektorin e Universitetit të Mjekësisë, Dr. Arben Gjata, zhvilluan një takim me studentët e këtij universiteti për të diskutuar një projektligj të propozuar nga Qeveria. Ky

projektligj synon të detyrojë punësimin e mjekëve të rinj brenda vendit për një afat 2-5 vjeçar dhe do zbatohet për të gjithë studentët aktualë dhe ata të rinj të programit të integruar të studimit "Mjekësi e përgjithshme".

Kjo nuk ishte hera e parë që opinioni publik u njoftua për një politikë obligative që kishte si qëllim të mbante mjekët e rinj në brenda vendit, duke i kushtëzuar ata me kryerjen e disa viteve punë në Shqipëri para se të merrnin diplomën e tyre. Kryeministri i vendit, Z. Edi Rama, ka lajmëruar për politikën e ardhshme të Qeverisë për bllokimin e diplomave të mjekëve të rinj fillimisht në tetor të vitit 2022⁵, por pa dhënë më shumë detaje ose afate kohore të aplikimit të kësaj mase.

Gjatë takimit të mbajtur më datë 17 qershor 2023, me Ministrat përkatës dhe Rektorin e Universitetit të Mjekësisë, studentët që ishin prezentë në takim shprehën kundërshtimin e tyre ndaj vendimit të ri dhe njoftuan se do të organizojnë protesta dhe do të bojkotonin procesin mësimor. Protesta e tyre fillimisht nisi më 19 qershor 2023, dy ditë pas zhvillimit të takimit, ku ata kërkuan anulimin e kësaj politike.

Projektligji me titullin "Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë 'Mjekësi e përgjithshme' në institucionet publike të arsimit të lartë"⁶ u paraqit në Kuvend më datë 5 korrik 2023, duke kaluar në proces të përshpejtuar.

Synimi i këtij projektligji është të sigurojë burime njerëzore për të përmbushur nevojat e vendit në sektorin e shëndetësisë, duke kushtëzuar studentët të punojnë brenda vendit pa mundësinë e marrjes së diplomës për një periudhë prej 2-5 vjetësh, në varësi të vitit të studimit.

Në mënyrë specifike, studentët e sapo regjistruar në programin e integruar "Mjekësi e përgjithshme" kanë detyrim të punojnë për pesë vite në një institucion shëndetësor në vend para se të kenë të drejtën për të marrë diplomën e tyre. Studentët nga viti i dytë deri në të katërt kanë detyrim të punojnë për 3 vite, ndërsa studentët e vitit të pestë dhe të gjashtë kanë detyrim të punojnë për 2 vite.

Studentët që do konkurojnë për programin e integruar "Mjekësi e përgjithshme" si edhe studentët aktualë të këtij programi, do duhet të nënshkruajnë një marrëveshje me Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Shëndetësisë, si edhe me Universitetin e Mjekësisë. Ndryshe nga studentët që do konkurojnë për këtë program, studentët aktualë kanë mundësinë që të

⁵ <https://www.evropaelire.org/a/mjeket-shqiperia-diplomat-/32094353.html>

⁶ <https://parlament.al/dokumentacioni/aktet/38f60467-9bdc-401c-a6d1-7246552603aa>

mos e nënshkruajnë marrëveshjen, por të paguajnë një tarifë vjetore sa kostoja reale e shkollimit të tyre. Kjo kosto përlogaritet në **678 994** lekë në vit⁷.

Pas shpalljes së Projektligjit, studentët kanë organizuar një tjetër protestë dhe kanë paralajmëruar për bojkot total të procesit mësimor gjatë vitit të ardhshëm akademik, si edhe padi në Gjykatën Kushtetuese nëse Qeveria nuk anulon vendimin⁸.

Shqipëria është vendi i parë në rajonin e Ballkanit Përfundimor që aplikon një politikë të mbajtjes së diplomës dhe detyrimit të punësimit të mjekëve të rinjë. Krahasuar me numrin e mjekëve mesatar në rajon, që është 2.5 mjekë për 1000 banorë, Shqipëria ka një numër më të ulët, rreth 1.5 mjekë për 1000 banorë.

Politika të ngjashme për frenimin e largimit të mjekëve ndjekin edhe shumë shtete të botës, të tilla si Kina, Afrika e Jugut, Filipinet, Brazili. Këto shtete kanë një numër të vogël mjekësh për 1000 banorë çka i detyron ato të krijojnë politika dhe incentiva të ndryshme për të mbajtur mjekët brenda vendit.

Në këto shtete, zbatohen programe të detyrueshme që zgjasin 1-2 vite, ku mjekët e rinj vendosen në zona rurale për të shërbyer aty ku ka më shumë nevojë. Pas përfundimit të periudhës së shërbimit, ata marrin diplomën e tyre dhe janë të lirë të vazhdojnë punën në vendin e tyre ose të largohen nga vendi.

⁷ <http://www.parlament.al:5000/Files/202307051716501840RELACION%20-%20STUDENTET%20E%20MJEKESISE.pdf>

⁸ <https://shqiptarja.com/lajm/projektligji-per-punesimin-e-detyruar-studentet-e-mjekesise-marshim-drejt-kuvendit-po-perdoremi-si-kavie-eksperimentale>

Gjetjet kryesore

- Në maturën shtetërore të vitit 2023 ka 7% më pak nxënës se vitin e kaluar. Çdo vit, vendi ka 2600 maturantë më pak.
- Rreth 40% e maturantëve të këtij viti kanë shprehur dëshirën për të studiuar jashtë vendit.
- Provimi i matematikës është provimi më i vështirë i maturës shtetërore, ndërsa provimi më i thjeshtë është ai i gjuhës së huaj.
- Provimi që ka numrin më të lartë të nxënësve me notë 10.00 është ai i gjuhës së huaj, ndërsa provimi me më pak nxënës të shkëlqyer është ai i gjuhës shqipe dhe letërsisë.
- Notat mesatare vjetore të nxënësve kanë ndryshime të ndjeshme kundrejt notave që ata marrin në provimet e maturës, duke sugjeruar ekzistencën e notave fiktive.
- Shqipëria bëhet i vetmi vend në botë ku mjekët e rinj duhet të punojnë për 5 vite brenda vendit në mënyrë që të marrin diplomën e tyre.

Rekomandime

- Notat e nxënësve në provimet e maturës nuk duhet të ndikojnë në pikët e nxënësve gjatë procesit të aplikimit universitar, për shkak të prezencës së notave fiktive në këto provime. Për të siguruar një proces aplikimi meritokratik, universitetet duhet të vendosin konkurse të informatizuara pranimi.
- Në vend që të imponojë detyrimin për të mbajtur mjekët e rinj brenda vendit, Qeveria duhet të zhvillojë politika tërheqëse duke ofruar kushte pune të përmirësuara dhe infrastrukturë cilësore në institucionet shëndetësore, si dhe paga konkurruese.

#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al